

Data 16 . 04 .2024

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës-PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

Objekti i prokurimit: “Ndërtimi i Shkollës 9- vjecare Ibrahim Hima”,

Kodi përkatës në fjalorin e përbashkët të prokurimit (CPV): 45210000-2, Punime ndërtimi.

Vlera e fondit limit: 159,965,350.59 (njeqind e pesedhjetë e nente milion e nenteqind e gjashtedhjetë e pese mijë e treqind e pesedhjetë pike pesedhjetë e nente) lekë pa TVSH.

Në bazë të Nenit 21, pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Nenit 2, pika 2/c si dhe Nenit 78, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

c. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

d. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 83, pika 1 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 30, pika 1.

Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 82 si dhe në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni II, Neni 26.

e. Vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatëse vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 7, gërma “a”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Sipas Shtojcës 7 të DST

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në Nenin 77, pika 1/a dhe pika 2, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

1. Për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qëndrueshëm Operatori ekonomik duhet të paraqesë Kopje të çertifikuara të bilanceve të 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) të paraqitur në Autoritetet përkatëse Dega e Tatim Taksave të konfirmuara nga ky Autoritet si dhe të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse në dy balance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit).

Shënim: Akt Ekspertiza e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, duhet të paraqitet nga OE vetëm në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, gërma “c” të Ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku parashikohet se: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese: “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, **për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm:** i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; si dhe Kreu V, Seksioni III, Neni 43, pika 4, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit Nr. 10091 date 5.3.2009 “Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” (i ndryshuar).

2. Kopje të deklaratimit të xhiros vjetore gjatë 3 (tri) viteve të fundit financiare (2021, 2022, 2023) lëshuar nga Autoriteti përkatës, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet konkretisht: **159,965,350.59** (njqind e pesedhjetë e nente milion e nenteqind e gjashtedhjetë e pese mijë e treqind e pesedhjetë pike pesedhjetë e nente) lekë pa TVSH. (Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur nëse Operatori ekonomik arrin vlerën e xhiros minimale në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga Autoriteti Kontraktor).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme mbështetet në Nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 43, pika 2 dhe pika 3 e VKM-së Nr.

285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.Kërkesat e renditura sipas Kapacitetit ekonomik dhe financiar (pika 1 dhe pika 2) i shërbejnë Autoritetit Kontraktor, për të provuar nëse Ofertuesit zotërojnë kapacitet financiar për të përmbushur me sukses kontratën objekt prokurimi.

3. Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2022 dhe për vitin 2023 sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, (i ndryshuar). Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotesimin e formularit të vetedeklarimit, dokumentet përkatëse vërtetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43, pika 6 të VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar). Duke qenë se Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, është njësi e vetëqeverisjes vendore, e cila funksionon dhe ka kompetenca të përcaktuara sipas Ligjit Nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Njësia e Prokurimit argumenton se pika 3 është vendosur në kuadër të Ligjit Nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar), Neni 5, gërma “c” ku citohet se: “...përcakton numrin e kësteve të pagimit të taksës dhe afatet e kryerjes së tyre, si dhe kushtet lehtësuese në rastet e pagesës së plotë dhe përpara afateve të detyrimeve fiskale”.

Kriteret e mëposhtme në lidhje me kapacitetin teknik janë hartuar dhe argumentuar nga specialisti i fushes, anëtar i njësisë së prokurimit.

Kapaciteti teknik:

Përsa i përket aftësisë teknike e profesionale, Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e mëposhtme minimale të cilat vendosen nga Autoriteti Kontraktor si më poshtë:

1.Përvojë e suksesshme në realizimin e të paktën:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **79,982,675.2** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **319,930,701.18** lekë pa TVSH.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e

pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

1.2 Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit Ekonomik do të kryhet bazuar në deklaratat e dokumentat e mëposhtme:

- a) Për kontrata të realizuara me ente publike, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr. 9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontratë Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim.
 - b) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, Operatori ekonomik duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:
 - Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës Nr.9 (ku të përcaktohet qartazi vlera, afati i perfundimit të kontratës si dhe natyra e punës së kryer);
 - Kontrate Sipërmarrje;
 - Situacionin përfundimtar;
 - Aktin e kolaudimit;
 - Çertifikatën e marrjes në dorezim/ Çertifikatën e Përkohshme të marrjes në dorezim;
 - Fatura tatimore perkatese.
- 1.3** Për kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: Kontratën e Bashkimit të operatoreve ekonomik si dhe prokurën e posaçme të deklaruar në fazën e tenderimit.
- 1.4** Për kontratat e realizuara si nënkontraktor, operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë: kontratën baze ndërmjet kontraktorit dhe autoritetit kontraktor, kontratën e nënkontraktimit dhe aktin e miratimit zyrtar si nënkontraktor.

Argumentimi: Përvoja e suksesshme si dhe vlerësimi i saj u hartua duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që:

- a. Punë të ngjashme për një objekt të vetëm me vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllëgaritur të kontratës që prokurohet konkretisht: **79,982,675.2** lekë pa TVSH, të realizuar gjatë pesë viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.
- b. Punë të ngjashme deri në një kufi ku vlera monetare totale e punëve të kryera e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit është në një vlerë jo më të vogël sa dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet konkretisht: **319,930,701.18**lekë pa TVSH.

Pika 1/a plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Kurse pika 1/b duhet të plotësohet nga të gjithë anëtarët e bashkimit në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Në rastin kur Operatorët ekonomik, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në Kontratën e Bashkëpunimit se cili prej tyre do ta përmbushë këtë kusht.

Gjithashtu referuar VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, Kreu XI, Neni 88, pika 3 citohet se: *”Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, kushti i përcaktuar në shkronjën “a”, të pikës 5, të nenit 39, të këtyre rregullave, plotësohet nga anëtari, i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontrata të ngjashme, në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim. Në rastin kur operatorët ekonomikë, anëtarë të një bashkimi, kanë të njëjtën përqindje pjesëmarrjeje në bashkim, vendosin me marrëveshje në kontratën e bashkëpunimit se cila prej tyre do të përmbushë këtë kusht.”* AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (1.2-1.4), të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

Përvoja e sukseshme si dhe vlerësimi i saj është hartuar duke iu referuar Nenit 77, pika 4 të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” ku qartazi përcaktohet se: *”Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie.*

Autoritetet ose entet kontraktore, në veçanti, mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të kenë një nivel të mjaftueshëm përvoja që vërtetohet nga referenca të përshtatshme nga kontratat e zbatuara në të shkuarën.

Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës.”, si dhe bazuar në Nenin 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *”Për të provuar përvojën e mëparshme, autoriteti/enti kontraktor kërkon: a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të madhe se 50% e vlerës së përlllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës; b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e madhe se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet. Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme. Autoriteti/enti kontraktor, si dëshmi për përvojën e mëparshme, kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve. Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës*

së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve”.

AK argumenton se Puna e ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave 1.3 dhe 1.4, të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e punëve publike të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Sqarojmë se nga praktika, gjatë fazes së vlerësimit të ofertave, AK ka hasur vështirësi në vlerësimin në mënyrë sa me të drejte të përvojës së ngjashme, pasi jo të gjitha institucionet shtetërore apo private leshojnë Formularin e Vlerësimit sipas formatit zyrtar (ku përcaktohet ndarja e përqindjeve). Në kuadër të vlerësimit të ofertave në mënyrë sa me të drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktim, vlerësimi i përvojës të vërtetohet me paraqitjen e kontratës së bashkëpunimit; me marrëveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit të nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta ketë çdo kompani në dosjen e saj, për rrjedhojë nuk mund të sjellë kufizim të pjesëmarrjes së OE në tender as në mënyrë direkte dhe as në mënyrë indirekte. Gjykojmë që kërkesa e mësipërme nuk është në kundërshtim me asnjë nga dispozitat ligjore që parashikon legjislacioni i prokurimit publik.

Gjithashtu vendos në kushte të barabarta dhe u jep mundësi të gjithë OE Ofertues edhe në ato rastet kur Formularët e Vlerësimit mund të jenë të paplotesuara sipas standartit.

AK ka kërkuar këto dokumenta në përputhje me parashikimet e Nenit 39, pika 5, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, ku ndër të tjera përcaktohet se: ***”Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, autoriteti/enti kontraktor kërkon si dëshmi, vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me fatura tatimore dhe çdo lloj dokumenti tjetër, që parashikohet nga legjislacioni në fuqi, që provon realizimin me sukses të punëve.”*** .

1. Liçensa profesionale, lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës:

Operatori Ekonomik duhet të disponojë Liçencë të shoqërisë e vlefshme për kategoritë e mëposhtme:

- NP-1 A Punime gjurmimi në tokë.
- NP-2 C Ndërtime civile dhe industriale.
- NP-7 A Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës , vepraq kullimi dhe vaditje
- NP-11 A Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.
- NP-12 A Punime të inxhinierisë së mjedisit.
- N.S-1 A Punime për prishjen e ndërtimeve
- N.S-2 A Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.
- NS-3 A Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).
- NS-4 C Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.
- NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe të kondicionimit.
- NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacione

- NS-18 A Punime topogjeodezike
- NS-20 A Shpime gjeologo-inxhinierike, puse e shpime për ujë.

sipas modelit të lëshuar nga institucioni përgjegjës për dhënien e licensave profesionale sipas legjisllacionit në fuqi.

Operatorët e huaj duhet të plotësojnë kërkesat e licensave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës sipas përcaktimeve më sipër. Operatori ekonomik i huaj të ketë në licencën e tij ato kategori punimesh të kërkuara në dokumentat e tenderit, pavarësisht se kategoria e kërkuar, nuk korespondon me të njëjtin numër kategorie me kategorinë e punimeve në licencën e një operatori të huaj të lëshuar nga vendi i origjinës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 1 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar si dhe Vendim te Keshillit te Ministrave Nr. 42 date 16.01.2008, ”Per miratimin e rregullores per kriteret dhe Procedurat e dhenies se licensave profesionale te zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit te Subjekteve juridike qe ushtrojne veprimtari ndertimi, gjithashtu Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton “Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Referuar kategorive të kërkuara, AK argumenton teknikisht se kjo kërkesë është vendosur sipas zërave të preventivit të punimeve. Kjo kërkesë është vendosur nga Autoriteti Kontraktor me qëllim shqyrtimin e kualifikimit profesional të Ofertuesve në kuadër të veprimtarisë tregtare objekt prokurimi.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjisllacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive
NP-1 A	Punime germimi ne toke	<p style="text-align: center;"><i>Emërtimi i Punimeve</i></p> <ul style="list-style-type: none"> • Germim dheu themele e plinta me b>2m, ekskavator me zinxhir 0.5m³,shkarkimi ne auto • Germim e mbushje dheu me krah kat III per themele, h=1.5m • Germim dheu me krah e transport k dore 10m,kat III • Germim dheu me ekskavator goma 0.25 m³, ne kanale gjeresi deri 2 m, toke zak, kategoria III, me shk ne mjet 	<p>0-21 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventivin e punimeve</p> <p>1,476,920.07</p>
NP-2 C	Ndërtime civile dhe industriale	<ul style="list-style-type: none"> • F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm • F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm • F V konstruksione metalike te perbera • F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm • F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm 	<p>51-100 milion lek</p> <p>Vlera e punimeve e parashikuar</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • Shtrese betoni C 12/15 • Shtrese betoni C 16/20 • Shtrese rere • Nenshtrese zhavori • Nenshtrese zhavori • Shtrese betoni C 12/15 • Breza b/a monolit C 16/20 • Mure b/a t = 11-20cm h ~ 4m C 16/20 • Pllake themeli, trare e bazamente b/a C 30/37 • Themel e xokol betoni C - 30/37 • Kollona b/a monolite C 30/37 h ~ 4m • Mure b/a t = 21-30cm, h ~ 4m C 30/37 (kafazi ashensorit) • Trare e arkitrare b/a C 30/37 h ~ 4m • Soleta te plota b/a C 30/37 t = 17 cm, h ~ 4m • Soleta te plota b/a C 30/37 t = 17 cm, h ~ 4m shkallet 	<p>ne preventiv</p> <p>55,015,599.94</p>
NP-7 A	Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës , vepraq kullimi dhe vaditje	<ul style="list-style-type: none"> • FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PE d=50mm, Pn 16 • FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=40mm, Pn 16 • FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~32mm, Pn 16 • Termoizolim tubi Ø 2" me armofleks (d64x9) • Termoizolim tubi Ø 1 1/2" me armofleks (d54x9) • Termoizolim tubi Ø 1 1/4" me armofleks (d42x9) • Termoizolim tubi Ø 1" me armofleks (d35x9) • F.V tub te zeze dhe rakorderi • FV Tubacione PEX/a DN1/2 (16x2.0) mm i termoizoluar ð =6 mm • FV Tubacione PEX/a DN1/2 (20x2.0) mm i termoizoluar ð =6 mm • F.V Bryla AL- PEX 16x1/2 F • FV Reduksione me fileto femer ne njeren ane 16 mm x 1/2" • F.V Kolektor shpendares 1/2" (2+2) • F.V Elemente montimi dhe mberthimi.(Shirit metalik, gozhde, fasheta) • FV Saracineska kendore me hollandez Ø3/4", Ø1 " te kolektoret • FV Saracineska kendore me hollandez Ø11/4 " te kolektoret • F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe gomina d 125 mm • F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe gomina d 110 mm • F.V Tub shkarkimi PP gri me gota dhe gomina d 75 mm • F.V Tub shkarkimi PP d 50 mm • FV Bryl 45° PP Ø50 • FV Bryl 45° PP Ø 75 • FV Bryl 45° PP Ø 110 • FV Bryl 90° PP Ø110 per klozetat • F.V Bryl 90° PP Ø 50 • FV Reduksione PP Ø75-Ø50 • F.V Reduksione PP Ø110-Ø75 • F.V Reduksione PP Ø200-Ø100 Ø200-Ø125 • F.V Brage PP DN 50/50 • FV Brage PP DN110/110 	<p>0-21 milion</p> <p>Vlera e parashikuar ne preventivin e punimeve</p> <p>6,763,144.09</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • FV Brage PP DN 75/50 • FV Brage PP DN 110/50 • FV Brage PP DN 110/75 • FV Brage PP DN 125/110 • FV Brage PP DN 125/75 • FV Qafore vete shuarse Ø 100 mm • FV Fasheta metalike me seksion rrethor dhe gomina elastomere per mberthimin e tubave Ø 100 Ø 125 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 160 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 200 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 250 mm • F.V Tubo I brinjzuar HDPE SN8 dn 315mm • F.V Tubo korrogato Ø 200mm dhe Ø 100 • F.V Puseta betoni (100 x 100) cm, me kapak me mbushje 72x72 cm, klasa C250 • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 160 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 200 mm • F.V Tubo PP magjstral i rrudhosur dn 250 mm • F.V Tubo I brinjzuar HDPE SN8 dn 315mm • F.V Kolektor shpendares 3/4" (4+2) • F.V Kolektor shpendares 1" (5+2) • F.V Kolektor shpendares 1" (6+2) • F.V Kolektor shpendares 1 1/4" (7+5) • F.V Kolektor shpendares 1 1/4" (8+3) • F.V Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=63mm, X8.6 PN 16 	
NP-11 A	<p>Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë.</p>	<ul style="list-style-type: none"> • F.V Çelesa e prizat 10 A • F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=2.0m • F.V tub plastmasi Ø 18-21mm • F.V tub plastmasi Ø 22-26mm • F.V tub plastmasi Ø 18-21mm • F.V tub plastmasi Ø 31-36mm • F.V. Panel metalik IP65(700x550x250mm) • F.V. Elektroda tokezimi, profil zingato e bakerizuar , L=1.5m • FV pusete plastike 40x40x40, kapak te forte RIC 1084+1086 • F.V Prize " Shuko" 16A, 230V, dy module, ngjyre e bardhe • Prize " Shuko" 16A, 230V, dy module, ngjyre e kuqe • Kanaline metalike e perforuar zingato me vrima S=150x75mm • F.V Kanaline metalike e perforuar me vrima S=100x75 mm • F.V Kthesa kanaline horizontale 90°, Bryl 150x75 mm • F.V Kthesa kanaline horizontale 90°, Bryl 100x75 mm • F.V Kthesa kanaline ne zbritje 90°, 150x75 mm • F.V Kthesa kanaline ne zbritje 90°, 100x75 mm • F.V Rakorderi plan "T" 150x75 mm • F.V Rakorderi plan "T" 100x75 mm • F.V Reduksion ne qender kanaline metalike ne plan (150-100)x75 mm 	<p>0-20 milion leke</p> <p>Vlera e parashikuar e punimeve</p> <p>7,101,225.15</p>

		<ul style="list-style-type: none"> • Konstruksione metalike te kanalave metalike (profile U, C, suporte mbeshtetes, dado, vida etj) • F.V Kuti, suporte, kapak, 3 module • F.V Kuti shperndares, montim brenda murit PT-7, IP 40 • F.V Zile elektrike D75, 230V, 75 dB • F.V Celes buton pulsant • F.V Tub i drejte rigid Ø=25mm, se bashku me brryla, Ti, bashkuese, aksesore per fiksimin e tubit ne tavan etj • F.V Tub i drejte rigid Ø=20mm, se bashku me brryla, Ti, bashkuese, aksesore per fiksimin e tubit ne tavan etj • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = (3x50+1x25)mm² • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 5 x 10 mm² • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 5 x 6 mm² • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 5 x 4 mm² • Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 4 mm² • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 2,5 mm² • F.V Percjelles nje polar, me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=450/750 V, tip N07V-K, S = 1 x 2.5 mm² • F.V Percjelles nje polar, me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=450/750 V, tip FS17, S = 3x(1 x 2.5) mm • F.V Terminale fundore per kablo TU Un=0.6/1 kV; S=1x50mm² • F.V Terminale fundore per kablo TU Un=0.6/1 kV; S=1x35mm² • F.V Terminale fundore per kablo TU Un=0.6/1 kV; S=1x25mm² • F.V Terminale fundore per kablo TU Un=0.6/1 kV; S=(6-10)mm² • F.V Terminale fundore per kablo TU Un=0.6/1 kV; S=(1.5-4)mm² • F.V Paneli Elektrik Kryesor Kati Perdhe - Shkolla (P.E.K-K.+0) • F.V Panel Elektrik Ambienti Teknik - Shkolla (K.E-M) • F.V Kuadri Elektrik Shperndares Palester - Shkolla (K.E-PA) • F.V Kuadri Elektrik Shperndares Kati Pare - (K.E.-K+1) • F.V Paneli Elektrik Shperndares Kati Dyte - (K.E-K+2) • F.V Kuadri Elektrik Shperndares UPS - Kati 0 dhe +2 • F.V Kuti, suporte, kapak, 3 module • F.V Çeles buton pulsant 16A, 230V 	
--	--	--	--

		<ul style="list-style-type: none"> • F.V Kuti shperndares 10x10x10cm, montim jashte tavanit IP55 • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 1,5 mm² • F.V Kablo multipolar bakri, Un=0,6/1 kV, tip FTG10OM1 type, S = 3 x 1,5 mm², rezistent ndaj zjarrit perj 90min • F.V Percjelles nje polar, me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=450/750 V, tip N07V-K, S = 1 x 1.5 mm² • F.V Kablo i kuq alarmi zjarri, rezistent ndaj zjarrit S=2x1mm², tipi FG40HM1, PH.30min • per mbrojtjen nga goditjet atmosferike • F.V Puseta betoni per linjen kryesore te furnizimit me energji elektrike, me kapak gize te rende me dim. 80x80x80cm • F.V Puseta betoni, me kapak gize te rende me dim. 40x40x40cm per ndricimin e jashtem • F.V Tubo korregato Ø=90mm, tip i rende me rezistence te larte mekanike • F.V Tubo korregato Ø=63mm, tip i rende me rezistence te larte mekanike • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 4 x 2.5 mm² • F.V Kablo multipolar bakri me izolim PVC, djeg.pa flake dhe emetim gazi, Un=0,6/1 kV, FG16OR16 type, S = 3 x 1,5 mm² • F.V Rele Muzgu modulare 16A, 250V • F.V Percjelles NO7V-K verdhe-jeshil S=1x16mm² • UPS, 3-fazor • V Ndriçues LED Panel inkaso, 60x60cm, 36W, 3600lm, 4000K • V Ndriçues plafon rrethor LED jashte murit, 18W, IP44 • V Ndriçues industrial LED L=1.2m, 43W, IP 65, 4000K, me difuzor opal hermetik • V Ndriçues LED plafon, I montuar jashte murit 25W, 2300lm, 4000K, IP65 • F.V Ndriçues evakuimi me shenjë tregues dalje (EXIT), rezistent ndaj zjarrit IP-40, IK 07, LED 8W bat.NiCd me autonomi 3orë • V Ndriçues emergjence, rezistent ndaj zjarrit, LED 8W, IK 07, IP-65,me bat.NiCd me autonomi 3orë • V Ndricues tip prozhektor, LED 100W, 16516lm, 4000K, IP66 per ndricimin e fushes sportive • V Shtyllë ndriçimi konike, çeliku e zinguar në të nxehtë dhe e lyer me bojë elektrostatische H=4,5m • V Ndricues konik dekorativ me llambë LED 54W, 3700lm, IP65 • V Central i alarmit te zjarrit, me 1 loop, tip inteligjent, i adresueshem, me regjistrim ngjarjesh • F UPS, 3- • F Ndriçues LED Panel inkaso, 60x60cm, 36W, 3600lm, 	
--	--	--	--

		<p>4000K</p> <ul style="list-style-type: none"> • F Ndriçues plafon rrethor LED jashte murit, 18W, IP44 • F Ndriçues industrial LED L=1.2m, 43W, IP 65, 4000K, me difuzor opal hermetik • F Ndriçues LED plafon, I montuar jashte murit 25W, 2300lm, 4000K, IP65 • F Ndriçues evakuimi me shenjë tregues dalje (EXIT), rezistent ndaj zjarrit IP-40, IK 07, LED 8W bat.NiCd me autonomi 3orë • F Ndriçues emergjence, rezistent ndaj zjarrit, LED 8W, IK 07, IP-65,me bat.NiCd me autonomi 3orë • F Ndriçues tip prozhektor, LED 100W, 16516lm, 4000K, IP66 per ndricimin e fushes sportive • F Shtyllë ndriçimi konike, çeliku e zinguar në të nxehtë dhe e lyster me bojë elektrostatische H=4,5m • F Ndriçues konik dekorativ me llambë LED 54W, 3700lm, IP65 • 	
NP-12 A	Punime të inxhinierisë së mjedisit.	<ul style="list-style-type: none"> • Trotuar, me 6 cm beton, me pllaka • Mbjellje bari ne skarpat • F.V. Fidane Peme dekorative • Sistemim, nivelim dhe pasurim me humus 5kg/m2 • Sistemim, nivelim dhe pasurim me humus 5kg/m2 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 1,295,649.39</p>
NS-1 A	Punime per prishjen e ndertimeve	<ul style="list-style-type: none"> • Prishje mur tulle pa pastrim • Prishje shtresa betoni • Prishje kollona, trare b/a 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 929,049.37</p>
NS-2 A	Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre.	<ul style="list-style-type: none"> • F.V lavaman porcelani • F.V WC allafrenga • F.V pisuar porcelan • F.V vaske dushi • F.V pilete dyshemeje Ø 50 • F.V lavaman porcelani importi me mishelator per PAK • F.V WC allafrenga importi per PAK • F.V minivalvola nderprerese te paisjet hidrosanitare • FV. Bojler elektrik, kapaciteti 80 lit. • F.V Mates uji d = 65 mm • FV Filter uji me rrjete DN 63 Pn 10 • FV Valvol nderprerese DN63 mm • FV Valvol moskthimi DN63 PN 6-10bar 	<p>0-20 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv 1,162,931.07</p>

NS-3 A	Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues).	<ul style="list-style-type: none"> • Montim ashensori • Furnizim ashensori PAK, 3 ndalesa 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>2,050,183.98</p>
NS-4 C	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese.	<ul style="list-style-type: none"> • Mur me tulla te lehtesuara deri - 3 m, LL.P. M-25 • Mur me tulla me 6 vrima, t=12cm h~3m, ll perz M 15 • Shtrese me pllaka porcelanat • Shtrese me pllaka porcelanat • Shtrese parketi • Shkalle montazhi mermeri • Shtrese me pllaka mermeri t=2cm • Shtrese me pllaka mermeri t=3cm • Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm • Hidroizolim me nje shtres astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B • Hidroizolim me dy shtresa astar me baze cemento. Pergatitur nga dy komponente A+B • Kasete shkarkimi me llamarine xingat • Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100 • Hidroizolim me emulsion bitumi dhe 2 k katrama • Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm • Shtrese termoizoluese me polisterol t=10 cm • Shtrese lluster cemento 1:2 t = 20 mm • Mbulim çatie me panele sanduich • Plintuse mermeri h = 10cm • Suva solete ~ 4 m me drejtues, me krah • Suva brenda mur tulle ~ 4m, me krah, llaç perzier M 25 • Suvatim me grafiato h > 4 m • Tavan i varur me pllaka gipsi 60x60cm • Veshje tavani me kartonxhes • Patinim tavani allçi (stuko) • Patinim muri allçi (stuko) • Plintuse grez h = 10 cm • Parapet shkalle e ballkone hekur Ø e korimano druri • Boje vaji siperfaqe metalik • Boje hidroplastike • Boje hidroplastike cilesi e larte • Pllake b/a granili mbi parapet tarace • F V dritare d/alumini plastike me dopio xham • Dyer d/alumini me mbushje element d/a. • F V dyer d/alumini plastike me dopio xham • F V dyer te brendeshme druri cilesi e II-te. • FV Shtrese termoizoluese me panele polipropileni (Igloo) h=15cm • FV Veshje muri me polisterol te thjeshte t=8cm rrjete+suva. • FV Veshje fasade me llamarine te zinkuar te lyster, perfshire nenstrukturen • F V Doreze antipanik dyer te jashtme 	<p>51-100 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>54,987,363.24</p>

		<ul style="list-style-type: none"> Trajtim sipërfaqësor betoni me helikopter me kuarc/boje 	
NS-12 A	Impiante teknologjik , termik dhe te kondicionimit	<ul style="list-style-type: none"> F.V Kapuç ajrimi ne tarrace vertikal Ø 110mm Ø 125 mm FV Elemente mberthyes e fiksues F.V Tub plastik ventilimi PP F.V Elemente montimi dhe mberthimi. (upa, fasheta, prizhioner, profile metalike, stafa, bulloneri,Upa metalike betoni, Gur fresibel, etj) Grile per thithjen e ajrit. ne forme rrethore mm Ø 100 mm Kondravalvul D100 mm F.V Bashkues antivibrues per aspiratoret e ajrit F.V Ventilator ne linje - Kapaciteti: 100 m³/h; - Fuqi nominale max – 20 W; - Tensioni: 220V - Renia e presionit - 50 Pa. F.V Tubo korrogato Ø 200mm dhe Ø 100 V Ajernxjeres automatik 1". V Termostat kontrolli I paisur me sensore per te matur temperaturen e ujit per kontrollin e valvolave 3-rrugeshe. V Panel komandimi automatik per komandimin e pomave dhe kaldajes si dhe kontrollin e sitemit te ngrohjes. V Kaldaja me Peleta e kompletuar me panel komandim dhe element sigurise perfshire.Ketu prfshihet dhe dhoma per depozitimin e lendes djegese. Fuqi ngrohese 210KW. V Depozite per depozitimin e peletave lendes djegese. F Kaldaja me Peleta e kompletuar me panel komandim dhe element sigurise perfshire.Ketu prfshihet dhe dhoma per depozitimin e lendes djegese. Fuqi ngrohese 210KW. F Depozite per depozitimin e peletave lendes djegese. F Oxhak Inoksi me dopio paret ne mes 2 pareteve te kete leshe xhami me spesor jo me te vogel se 25mm te perfshuhet dhe pjeset speciale si byrla dhe ti inoxi AISI300 me diameter Φ=200/250mm. 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>8,365,141.77</p>
NS-13 A	Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni	<ul style="list-style-type: none"> F.V Kuti shperndares 10x10x10cm, montim jashte tavanit IP55 F.V Priza interneti, tip RJ-45 FTP - Cat.6, metalike e skermuar F.V Priza telefonie, tip RJ-45 FTP - Cat.6, metalike e skermuar F.V Konektore lidhes rrjeti me dy koka RJ-45 FTP-Cat.6, L=0.5m, metalike e skermuar F.V Kuti, suporte, kapak, 3 module F.V Kuti shperndares , montim brenda murit PT-6, IP40 F.V Kuti shperndares , montim brenda murit PT-7, IP40 F.V Kabllo rrejtje kompjuterik , tip F/FTP - Cat.6, 350MHz deri ne 400 MHz, LSZH F.V Koka per kablllo rrjeti, tip RJ-45 FTP-Cat.6, metalike e skermuar F.V Konektore lidhes rrjeti me dy koka RJ-45 FTP-Cat.6, 	<p>0-21 milion leke Vlera e parashikuar ne preventiv</p> <p>2,502,273.18</p>

		<p>L=0.5m, metalike e skermuar</p> <ul style="list-style-type: none"> • F.V Kablo rrjeti kompjuterik, tip F/FTP-Cat.6, 350MHz deri ne 400 MHz, LSZH • F.V Aksesore montimi te pershtatshem per instalimin e kamerave te jashtme dhe te brendshme • F.V Kablo zjarr durues 2x1.5mm² [FRS15 FE 180 PH 90] • F.V Kabell I parafabrikuar per komunikim central-amplifikator • F.V Kabell I parafabrikuar per komunikim central-mikrofon • F.V Kablo rrjeti kompjuterik, tip F/FTP-Cat.6, 350MHz deri ne 400 MHz, LSZH • F.V Kuti shperndarese , montim jashte murit PT-2-5, IP40 • V RACK kompjuetrik 19" 32U (Dimesionet 1600xW600xH600mm), • V RACK kompjuetrik 19" 15U (Dimesionet 760xW600xH600mm), me 1 module ushqimi • V RACK kompjuetrik 19" 9U (Dimesionet480xW600xH440mm), me 1 module ushqimi me 8 priza " Shuko " 230V/16A + PE, I kompletuar grupin e modulit te ventilimit • V Central i sistemit te telefonie PABX 4 linja hyrje, 12 linja dalje • V Patch panel per rrjetin e internetit + TF, me 24 porta RJ-45, tip FTP-Cat.6 • V Switch per rrjetin e IT-së, me 24 porta RJ-45 + 2 porte per fiber optike, tip FT -Cat.6 • V Patch cord fiber optike me 2 koka konektoriale L=1m • V Kamera e brendshme, tip Dome POE IP, 5Mpx • V Kamera e jashtme, tip Bullet IP POE, 5Mpx, IP 66 • V NVR (Network Video Recorder), me 24 kanale, 1U, 19" per montim ne rack, (Programim, testim & komisionim i sistemit te vezhgimit CCTV) • V Patch panel per rrjetin e CCTV, me 24 porta RJ-45, tip FTP-Cat.6 • V Switch i menaxhueshem Smart POE me 24 Porta RJ45 FTP Cat.6 + 2 porte per fiber optike, tip FT -Cat.6 • V HDD 4TB 3,5 inch. Kapaciteti 4000GB, Sata. Purple HDD (i dizenuar vecanerisht per Security, per te punuar 7dite ne Jave, 24 ore. Si edhe me jetegjatesi me te gjate se nje HDD i zakonshem kompjuteri ndaj ofron me shume garanci ne sherbim) • V Monitor 32" LED, per monitorimin e kamerave • V Boks tavanor inkaso, 6W, me transformator @100V, tip metalik, rezistent ndaj zjarrit, i certifikuar EN 54-24 • V Boks tip projektore audio, 20W, me transformator @100V, tip metalik, IP65, rezistent ndaj zjarrit, i certifikuar EN 54-24 • V Amplifikator Fuqie me shume kanale sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849, 500 W me 4 Zona (sipas sistemit te zgjedhur) • V Njesi qendrore kontrolli Central controlling unit 	
--	--	---	--

		<p>[Digital Int. System Manager] sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849</p> <ul style="list-style-type: none"> • V Mikrofon sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849, Touchscreen dhe me mundesi komandimi te te gjitha zonave (sipas sistemit te zgjedhur) • V Modul ushqimi per te gjitha elementet te sistemi te lajmerimit publik zanor dhe audio, se bashku me grupin e baterive, I kompletuar me te gjitha aksesoret sipas certifikimit te standardit EN 54-16 dhe EN 60849 • V Panel i alarmit ne raste emergjence me mikrofon per lajmerimit publik, I kompletuar me te gjitha aksesoret sipas certifikimit te standardit EN 54-16 dhe EN 60849 • V Tuner/CD Player MP02 me komunikim me centralin e lajmerimit publik zanor • V Pajisje ne fund te linjes per kontrollin e linjes se audios, sipas certifikimit te standardit EN 54-16 dhe EN 60849 • V Programim, testim dhe komisionim i sistemit te sinjalizimit zanor • F RACK kompjuetrik 19" 32U (Dimesionet 1600xW600xH600mm), • F RACK kompjuetrik 19" 15U (Dimesionet 760xW600xH600mm), me 1 module ushqimi me 8 priza " Shuko " 230V/16A + PE, I kompletuar grupin e modulit te ventilimit • F RACK kompjuetrik 19" 9U (Dimesionet480xW600xH440mm), me 1 module ushqimi me 8 priza " Shuko " 230V/16A + PE, I kompletuar grupin e modulit te ventilimit • F Central i sistemit te telefonie PABX 4 linja hyrje, 12 linja dalje • F Patch panel per rrjetin e internetit + TF, me 24 porta RJ-45, tip FTP-Cat.6 • F Switch per rrjetin e IT-së, me 24 porta RJ-45 + 2 porte per fiber optike, tip FT -Cat.6 • V Patch cord fiber optike me 2 koka konektoriale L=1m • F Kamera e brendshme, tip Dome POE IP, 5Mpx • F Kamera e jashtme, tip Bullet IP POE, 5Mpx, IP 66 • F NVR (Network Video Recorder), me 24 kanale, 1U, 19" per montim ne rack, (Programim, testim & komisionim i sistemit te vzhgimit CCTV) • F Patch panel per rrjetin e CCTV, me 24 porta RJ-45, tip FTP-Cat.6 • F Switch i menaxhueshem Smart POE me 24 Porta RJ45 FTP Cat.6 + 2 porte per fiber optike, tip FT -Cat.6 • F HDD 4TB 3,5 inch. Kapaciteti 4000GB, Sata. Purple HDD (i dizenuar vecanerisht per Security, per te punuar 7dite ne Jave, 24 ore. • F Monitor 32" LED, per monitorimin e kamerave • F Boks tavanor inkaso, 6W, me transformator @100V, tip metalik, rezistent ndaj zjarrit, i certifikuar EN 54-24 • F Boks tip projektor audio, 20W, me transformator @100V, tip metalik, IP65, rezistent ndaj zjarrit, i certifikuar EN 54-24 • F Amplifikator Fuqie me shume kanale sipas certifikimit 	
--	--	--	--

		<p>EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849, 500 W me 4 Zona (sipas sistemit te zgjedhur)</p> <ul style="list-style-type: none"> • F Njesi qendrore kontrolli Central controlling unit [Digital Int. System Manager] sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849 • F Mikrofon sipas certifikimit EN 54-16 dhe ne perputhje EN 60849, Touchscreen dhe me mundesi komandimi te te gjitha zonave (sipas sistemit te zgjedhur) • F Modul ushqimi per te gjithë elementet te sistemi te lajmerimit publik zanor dhe audio, se bashku me grupin e baterive, I kompletuar me te gjithë aksesoret sipas certifikimit te standardit EN 54-16 dhe EN 60849 • F Panel i alarmit ne raste emergjence me mikrofon per lajmerimit publik, I kompletuar me te gjithë aksesoret sipas certifikimit te standardit EN 54-16 dhe EN 60849 • F Tuner/CD Player MP02 me komunikim me centralin e lajmerimit publik zanor • F Pajisje ne fund te linjes per kontrollin e linjes se audios, sipas certifikimit te standardit EN 54-16 dhe EN 60849 • F Programim, testim dhe komisionim i sistemit te sinjalizimit zanor 	
--	--	--	--

N.P-1A (Punime gërmimi në tokë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me gërmime në tokë, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-2 C (Ndertime civile dhe industriale)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me ndërtimin e një objekti civil, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-7A Ujësjellës, kanalizime, vepra kullimi e vaditje

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per Ujësjellës, kanalizime, sistem vaditje etj, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *N.P-7A* , me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NP-11 A (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve, linja e tensionit të lartë e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen per ndricimin, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me kategorine *NP-11A*, me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.P-12 A (Punime të inxhinierisë së mjedisit)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me Punime të inxhinierisë së mjedisit, vepra kullimi e vaditje, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-1 A (Punime për prishjen e ndertimeve)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me prishje të strukturave të betonit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

N.S-2 A (Impiante hidro-termosanitare dhe mirëmbajtja e tyre)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka zëra pune që lidhen me impiantet hidro-termosanitare si sistemi kundër zjarrit, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-3 A (Impiante ngritëse dhe transportues (ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka vendosjen e ashensorëve, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-4 C (Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniturë me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniturë të natyrës teknike ndërtuese).

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e muraturës të godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-12 A Impiante teknologjik, termik dhe të kondicionimit.

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e sistemit të ngrohjes dhe ventilimit të godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-13 A Impiante dhe linja telefonie dhe telekomunikacioni

Në Preventivin e punimeve për procedurën objekt prokurimi ka ndërtimin e sistemit të kamerave të godinës, ndaj është e nevojshme që Operatori ekonomik që do të shpallet fitues të jetë i licensuar me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

NS-18 A.

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit, i cili lidhet me ndërtimin e një shkolle dhe një, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorinë N.S 18 A ku është pjesë e rëndësishme punimet topografike.

NS-20 A.

Duke marrë në konsideratë objektin e prokurimit dhe duke patur parasysh problematikat që mund të hasen nga eksperinca në objekte të mëparshme , i cili lidhet me ndertimin e një objekti, është e nevojshme që Operatori ekonomik të jetë i licensuar për kategorine N.S 20 A ku është e rëndësishme shpimet gjeologjike për ndërtimin e objektit.

Klasifikimi sipas niveleve për çdo kategori punimesh zbatimi i referohet Vendimit të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”

2. Operatori ekonomik duhet të përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe do të jetë i pranishëm gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt, të figurojë në listpagesat e shoqërisë minimumi per 3 (tre) muajt e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave, shoqeruar me dokumentacionin e mëposhtme:
 - a) Librezë pune;
 - b) Kontratë pune e vlefshme;
 - c) Diplomë.

(Ne rastin e Bashkimit te Operatoreve Ekonomik secili Operator duhet te përcaktojë me anë të një deklaratë Drejtuesin Teknik të punimeve në objekt, i cili duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të deklaroje se nuk është i angazhuar në kontrata të tjera dhe te jetë i pranishem gjate gjithë kohes qe do te kryhen punimet ne objekt ne varesi te vleres se preventivit te punimeve qe ka marre persiper sipas përqindjes se bashkepunimit).

Argumentimi: *Së pari*, kjo kërkesë mbështetet ne Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti, duke qenë se objekt prokurimi është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2, datë 13.05.2005 “ Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se: “drejtuesit ligjore dhe teknik te sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet, sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit

Lidhur me kërkesën që Drejtuesi Teknik i punimeve në objekt duhet të jetë i përfshirë në liçencën e shoqërisë dhe të mos jetë i angazhuar në kontrata të tjera, mbështetet në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42, datë 16.1.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike, që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, pika 2 ku përcaktohet se: “Papajtueshmëritë me detyrën e drejtuesit teknik të shoqërisë së zbatimit Drejtuesit teknikë të shoqërisë nuk mund të jenë personat që janë të angazhuar në çdo punë-marrje tjetër publike.

Drejtuessi teknik i shoqërisë nuk mund të jetë njëkohësisht i punësuar në dy apo më shumë shoqëri ndërtimi dhe ndalohet të disponojnë licencë për mbikëqyrje e kolaudim të punimeve të zbatimit” dhe pika 2: “elementët e licensës” gërma “c” ku citohet se: “Licencat e shoqërive jepen me afat të njëjtë me atë për të cilin janë regjistruar për të ushtruar veprimtari në QKR apo gjykatë. Ndalohet ushtrimi i veprimtarisë zbatuese në ndërtim në mungesë të drejtuesit/ve teknikë të shoqërisë. Shoqëritë e licencuara jo më vonë se 10 ditë kalendarike, kur drejtuesi teknik është dorëhequr ose ka pamundësi fizike për ushtrimin e detyrës (aksident, sëmundje me paaftësi ushtrimi detyre mbi 14 ditë, invaliditet, ndarje nga jeta), kanë detyrimin të paraqesin njoftim së bashku me kërkesën për drejtuesin e ri teknik të shoqërisë”.

Për sa më lart, çdo kërkesë e renditur për Drejtuesin Teknik, buron nga kontrata e punës objekt prokurimi, me qëllim përmbushjen dhe realizimin e saj sipas kushteve dhe dispozitave ligjore në fuqi.

- 3.** Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim mesatar minimumi **45 (dyzet e pesë)** punonjës të vertetuar me: Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave dhe listpagesat perkatese të konfirmuara nga autoritetet përgjegjëse, shoqëruar me formularët e deklarimit të pagesave për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore. *(Kjo kërkesë do të konsiderohet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetëdeklarimit, dokumentet perkatese vertetuese do të paraqiten nga operatori ekonomik i klasifikuar i pari, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit).*
- 4. Argumentimi:** Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “ç”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës.

Nga ana teknike argumentojmë se numri mesatar i punonjësve, prej gjithsej 45 punonjësish, është caktuar në bazë të llogaritjeve të zërave të punës dhe volumit përkatës të cdo zëri në preventiv si dhe grafikut në zbatimit të punimeve, të cilat duhet të përfundojnë brenda 12 muajve kalendarike, mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi. Numri i punëtorëve si dhe personeli i nevojshëm për zbatimin e kontratës është përcaktuar duke marrë në konsideratë vlerën e kontratës që prokurrohet, natyrën si dhe kohëzgjatjen e saj si dhe duke u mbështetur mbi përvojën e mëparshme që ka pasur AK në zhvillimin e procedurave me objekt të ngjashëm dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për t’u njohur me kapacitetet profesionale të ofertuesve me qëllim përmbushjen e kontratës me sukses.

Gjithashtu për të vërtetuar zotërimin e fuqisë punëtore si dhe stabilitetin e saj është kërkuar edhe vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore si dhe listpagesat e punonjësve mbështetur edhe në Kreun V, Seksioni III, Neni 39, pika 8 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” sipas së cilës: *”Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”*.

5. Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf inxhinierik për kryerjen e të gjitha punimeve në objekt, të përfshirë në licencën e shoqërisë, të vërtetuar me kontratë pune të vlefshme, librezë pune, diplomë përkatëse si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për 3 (tre) muajt e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, konkretisht:

- 1 (një) Inxhinier Ndërtimi;
- 1 (një) inxhinier Hidroteknike;
- 1 (një) inxhinier Elektrik;
- 1 (një) inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder;
- 1 (një) inxhinier Mjedisi
- 1 (një) arkitekt
- 1(një) inxhinier mekanik;

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Kërkesa specifike për Inxhinierët e kërkuar është përcaktuar në kuadër të analizës teknike që i është bërë Preventivit të Punimeve (nga ku përcaktohet qartazi dhe profili inxhinierik) si dhe në bashkëndim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë sipas pikës 2, kapaciteti teknik në DST. Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar sipas DST, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Duke marrë në konsideratë Projektin e zbatimit si dhe Preventivin e Punimeve rezulton se është e domosdoshme që çdo Ofertues të ketë pjesë të stafit Inxhinierë të kërkuar, të cilët në bashkëpunim me njëri tjetrin ,stafin mbështetës si dhe me fuqinë punëtore të shoqërisë do të realizojnë me sukses kontratën objekt prokurimi.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar N.P –1A, N.P –4D, N.S – 6A, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit të Ndërtimit dhe arkitektit**.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **NP7 A**, është e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Hidroteknik**.

Referuar preventivi të Punimeve si dhe në bashkëvendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku është kërkuar **NP11 B**, është e nevojshme prezenca e Inxhinierit Elektrik.

Referuar preventivit te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NS 18**, eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinier Gjeodet/Topograf/Markshajder**, pasi çdo matje që do të bëhet në funksion të objektit të prokurimit kërkon domosdoshmërisht praninë e këtij Inxhinieri.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NP12** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit te Mjedisit**.

Referuar preventivi te Punimeve si dhe në bashkerendim me kategoritë e kërkuara në Licencën profesionale të shoqërisë ku eshte kerkuar **NS3 dhe NS12** eshte e nevojshme prezenca e **Inxhinierit Mekanik**.

6. Operatori/ët ekonomik duhet të ketë në stafin e tij 1(nje) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin në përputhje me klauzolat Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin", Neni 49, pika 4, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin.

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për *specialistin Ekspert Zjarrfikes* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”, si dhe në mbështetje të Nenit 49, pika 4 të Ligjit Ligjit Nr. 152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin".

Theksojmë se, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimi etj të cilat kanë potencial të shkaktitimit të aksidenteve me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e **1 (nje) specialist Ekspert Zjarrfikes ne fushen e mbrojtjes nga zjarri dhe per shpetimin**.

7. Operatori/et ekonomik duhet të kenë në stafin e tyre personel të kualifikuar/çertifikuar si:

- a) 1 (një) punonjes i pajisur me çertifikate “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga shoqeri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 1 (një) punonjës "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave").

- b) 1 (një) punonjës me çertifikatë "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë" në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10327 datë 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M Nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier", shoqëruar me kontratë individuale pune të vlefshme, Diplome/certifikate, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave. (Në rastin e Bashkimit të Operatorëve

ekonomikë, secili prej Operatorëve duhet të ketë pjesë të stafit të tij 2 (dy) punonjës "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë").

Argumentimi: AK argumenton se kërkesa për 1 (një) *Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë* është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 77, pika 4; të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma "c", si dhe në mbështetje të Nenit 7 të Ligjit Nr. 10237, datë 18.02.2010 „Për sigurinë dhe shëndetin në punë“, sipas të cilit: „Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarës që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë.....“.

Theksojmë se, Autoriteti Kontraktor ka qëllim realizimin e kontratës objekt prokurimi sipas kushteve të përcaktuara në DST, duke respektuar çdo rregull lidhur me kantierin e ndërtimit si dhe me sigurinë e punonjësve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës. Është e rëndësishme që punimet të realizohen brenda një kantieri të sigurt duke mbrojtur jetën e punonjësve, por dhe të kalimtarëve që mund të jenë përreth vendit të punimeve. Për sa më lart, punonjësit të cilët janë të çertifikuar si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë", nëpërmjet dijes dhe eksperiencës të fituar në këtë fushë, duhet të shmangin apo parandalojnë çdo rrezik që mund të shfaqet gjatë veprimtarisë së shoqërisë dhe që mund të çënojë shëndetin apo sigurinë në punë. Në këto kushte, vendosja e këtij kriteri shërben si një garanci që Ofertuesit do të realizojnë punimet sipas standarteve ligjore në fuqi.

Gjithashtu, për shkak të natyrës së punimeve që kryhen: punime elektrike, saldimit etj të cilat kanë potencial të shkaktojnë aksidente me rrezik zjarri kërkohet një specialist për të bërë planin e masave dhe evakuimin në raste aksidentesh ndaj zjarrit prandaj shihet e nevojshme dhe e domozdoshme prania e 1 (një) punonjesi të pajisur me çertifikate "Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave".

8. Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar staf teknik për kryerjen e punimeve, të vertetuar me kontratë punë të vlefshme, diplome lëshuar nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriati Shtetëror Teknik dhe Industrial apo nga subjekte juridike private të akredituara për çertifikimin e punonjësve), si dhe të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi për periudhën e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave, si më poshtë:

- 1 (një) Teknik ndertimi
- 1 (një) Teknik mekanik
- 1 (një) punonjes hidraulik
- 1 (një) punonjes elektrikist
- 1 (një) punonjes mekanik
- 2 (dy) punonjes bojaxhi
- 2 (dy) punonjes murature
- 1 (nje) punonjës saldator
- 1 (një) punonjës hidroizoules
- 1 (një) Punonjes eskavatorist
- 1 (një) punonjes pllakashtrues

1 (një) punonjes automakanist

Argumentimi: Kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4; në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Qëllimi i vendosjes së këtij kushti është i implementuar sipas dispozitave ligjore dhe shërben si një garanci që kontrata objekt prokurimi do të realizohet me sukses sipas Specifikimeve Teknike (të cilat do publikohen së bashku me Dokumentat e Tenderit) si dhe punimet do të kryhen brenda afatit kohor të parashikuar në Njoftimin e Kontratës. Sqarojmë se, të gjithë specialistët e kërkuar janë në përputhje të plotë me projekt-preventivin duke marrë në konsideratë volumet e punes qe do te realizohen,si dhe kohëzgjatjen e tyre. Autoriteti Kontraktor domosdoshmërisht duhet të garantohet që këto punime do të kryhen nga persona të kualifikuar dhe me eksperiencë të mjaftueshme, për zbatimin e këtyre punimeve sipas standarteve te percaktuar ne specifikimet teknike. Për të vërtetuar kualifikimin e stafit teknik është kërkuar që të jenë të pajisur me diplomë/dëshmi përkatëse lëshuar nga institucione të akredituara nga autoritetet përgjegjëse shtetërore, dëshmi kualifikimi të sigurimit teknik, (të vlefshme) lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik. Certifikimet/diplomat profesionale duhet të jenë te lëshuara nga instuticione te licensuara nga organet përkatëse, mbështetur ne Ligjin Nr. 15/2017 “PËR ARSIMIN DHE FORMIMIN PROFESIONAL NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË” Mbështetur në këtë legjislacion certifikimet profesionale ofrohen nga instuticione të licensuara nga Ministria përkatëse nëpërmjet Agjencise Kombëtare te Arsimit, Formimit Profesional. Certifikatat e këtyre specialisteve duhet të jenë të të regjistruara në “regjistrat profesionale” të AKAFP-se.

Ne lidhje me 1 (dy) Teknik ndertimi prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

1 (një) teknik mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

1 (një) punonjes hidraulike prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

1 (një) punonjes elektriciste prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

1 (një) punonjës mekanik prezenca e tij në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

2(dy) punonjes bojaxhi prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

2(dy) punonjes murature prezenca e tyre në kantierin e ndërtimit garanton autoritetin kontraktor për zbatimin e punimeve të preventivit me sukses kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve te punes qe do te realizohen ne baze te analizes teknike .

1 (një) eskavatorist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) punonjës hidroizolues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) saldator kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) hidroizolues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) pllakashtrues kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

1 (një) automekanist kjo kërkesë përputhet me punimet e preventivit si dhe referuar volumeve të punës që do të realizohen në baze të analizës teknike.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësisia e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributor autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në mënyrë që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimit CE, certifikatat e cilësisë ose raportet e testimit nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standarteve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gjukejme të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë

me që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në menyre të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilesie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilesie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës sipas pikës 9, garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjisë së re dhe bashkëkohore.

9. Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë autorizim prodhuesi ose distributori. Në rast paraqitje autorizim distributori duhet të paraqitet kontrata ose dokumenti i angazhimit midis prodhuesit dhe distributorit, për materialet (elektrike, tuba, bojra). Për materialet e kërkuara OE duhet të paraqesë katalogun/et ose skedat teknike të prodhuesit/ve, ku të specifikohen materialet që do të ofrohen si dhe të paraqiten certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Operatori ekonomik duhet të specifikojë në formë tabelle: emrin e kompanisë prodhuese, emërtimin e katalogut të artikullit/produktit, Nr. e faqes ku ndodhet produkti, emërtimin e artikullit (kodi) nxjerrë nga manuali i prodhuesit, linku i produktit në ëeb-in e prodhuesit si dhe certifikimet përkatëse për secilin produkt.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 8, si dhe”, në bazë të nenit 45, pika 1 të VKM-së Nr. 285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Kjo kërkesë është kërkuar që ti sigurojë Autoritetit Kontraktor që operatori ekonomik ka kapacitetin e nevojshëm Teknik dhe plotëson specifikimet e kërkuara nga projektuesit për zbatimin në kohë dhe cilësi të kontratës për këtë objekt. Për të krijuar bindjen e autoritetit kontraktor për aftësitë teknike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur të operatorëve ekonomik fitues potencialë dhe realizimin me sukses të kontratave, njësi e prokurimit vlerëson se operatorët ekonomikë duhet të paraqesin autorizim nga prodhuesi/distributori, me të cilin prodhuesi/ distributori autorizon kompaninë pjesëmarrëse në tender të ofertojë pajisjet dhe mallrat e nevojshme në këtë procedurë prokurimi. Duke qenë se materialet e kërkuara prodhohen në mënyrë industriale, certifikimi nga prodhuesi mbi parametrat e tyre është i domosdoshëm. Në menyre që Autoriteti Kontraktor të verifikojë që specifikimet teknike të paisjeve të propozuara nga operatorët ekonomik plotësojnë parametrat dhe standartet e kërkuara në specifikimet teknike të përcaktuara në dokumentat e tenderit, duhet të paraqitet dokumentacioni i kërkuar si: certifikatë/deklaratë konfirmimiti CE, certifikatat e cilësive ose raportet e testimi nga laboratorë të akredituar, me qëllim përmbushjen e standardeve të kërkuara në Specifikimet teknike.

Duke marrë shkas nga tipologjia e objektit të prokurimit dhe nga punimet/shërbimet që parashikohen të realizohen në preventive si dhe për shkak të interesit të lartë që ka objekti duhet të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane. Prandaj e gënjykojmë të domosdoshme të garantohet që mallrat kryesore të jenë sipas standarteve më të mira europiane, që OE ka aftësi të mjaftueshme për të realizuar me sukses dhe cilësi kontratën, duke furnizuar brenda kohës së përcaktuar vetëm pajisje origjinale me garanci, si dhe i shërben Autoritetit Kontraktor për të bërë krahasueshmërinë e materialeve të ofruara nga operatori me ato të kërkuara në dokumentat e tenderit.

Për të siguruar këtë gjë, por njëkohësisht dhe për të detyruar ofertuesit e mundshëm në zbatimin e këtyre standarteve ka parashikuar kërkesën e mësipërme vetëm për disa nga mallrat kryesorë me qëllim që do të përdoren në këtë objekt konkretisht OE duhet të japin dhe paraqesin në mënyrë të detajuar karakteristikat teknike të mallrave të përfshirë në dokumentat e tenderit, karakteristika këto që duhet të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga projektuesi.

Për këtë, ofertuesit duhet të deklarojnë produkte të pajisura me certifikatë konformiteti CE/certifikate cilësie etj. Me anë të venies në dispozicion në fazën e ofertimit dokumentat si autorizim-marreveshje angazhimi, skeda teknike, certifikata cilësie, certifikata konformiteti, raporte testimi ofertuesi garanton Autoritetin Kontraktor se mallrat që do të furnizojë do të jenë prodhim sipas kërkesave të projektit. Plotesimi i kërkesës në pikën 2.17 garanton Autoritetin Kontraktor për cilësinë dhe standartet e larta ndërkombëtare dhe të përditësuara sipas teknologjive të reja dhe bashkëkohore.

10. Operatori ekonomik duhet të paraqesë grafikun e punimeve të detajuar sipas zërave të preventivit (Bashkëlidhur DST) të shprehur në afatin kohor të përcaktuar në dokumentat e tenderit për **12 (dymbëdhjete) muaj** kalendarike.

11. Operatori ekonomik duhet të paraqesë certifikatat si më poshtë:

- a. Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO të sipërcituar).
- b. Certifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 14001-2015 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO të sipërcituar).
- c. Certifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018, (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Certifikatën ISO të sipërcituar).
- d. Certifikatën e menaxhimit të energjisë ISO 50001-2018 (e vlefshme) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtare Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, Operatori ekonomik që në bazë të marrëveshjes së bashkëpunimit do të marrë përsipër realizimin e zërave elektrikë të Preventivit duhet të paraqesë Certifikatën ISO.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara sipas pikës 14 gërma “a”- “e” janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 79, pika 1 ku citohet se: *“Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë”*, si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit”*.

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t’i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron një kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtarë, i cili parashtron kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për çdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushje me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 50001-2018 është një standard i ri i konceptuar për të asistuar kompanitë në zbatimin e një sistemi të menaxhimit të përshtatshëm për identifikimin dhe minimizimin e konsumit energjetik. AK gjykon se çdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 50001:2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi), të reduktojë kostot energjetike të kompanive, emisionet e gazrave serë (GHG) dhe impaktet e tjera në mjedis. Në Preventivin e punimeve parashikohen zëra elektrik, ku zbatimi i tyre kërkon që Ofertuesi të jetë i pajisur me Certifikatë ISO 50001-2018. Në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar), Kreu XI, Neni 88, pika 3, cilësohet se: “Secili prej anëtarëve të këtij bashkimi duhet të përmbushë kërkesat e parashikuara në nenin 76 të LPP dhe ato të përcaktuara në dokumentet e tenderit. Kërkesat për kualifikim ekonomike, financiare,

profesionale dhe ato teknike duhet të përmbushen nga i gjithë bashkimi, në përputhje me përqindjen e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në akt marrëveshje”. Për sa më lart, Njësia e Prokurimit, gjykon se, kjo kërkesë në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik duhet të përmbushet nga Shoqëria e cila referuar Marrëveshjes së Bashkëpunimit ka marrë përsipër të realizojë zerat elektrike te pasrashikuara sipas Preventivit.

AK gjykon se kërkesa për pajisjen e Ofertuesve me Çertifikatat e kërkuara sipas pikës 14 gërma “a”- “d”, është brenda kuadrit të parashikuar nga legjislacioni për prokurimin publik. Çertifikatat e kërkuara janë në përpjestim me objektin e kontratës dhe respektojnë natyrën e punimeve.

12. Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratës (Shtojca 8) konkretisht:

Nr	Emri i mjetit	Njesi	Sasi	Statusi
1	Autovinç 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
2	Vinç kulle deri ne 5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
3	Vinç kulle deri ne 6-10 Ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
4	Autopompë betoni	copë	1	Në pronësi ose me qera
5	Matrapik	copë	2	Në pronësi ose me qera
6	Trapano	copë	2	Në pronësi ose me qera
7	Elektroorgano	copë	1	Në pronësi ose me qera
8	Autobot	copë	1	Në pronësi ose me qera
9	Betonjere 500l	copë	2	Në pronësi ose me qera
10	Vibrator thellesie	copë	1	Në pronësi ose me qera
11	Vibrator siperfaqsor	copë	1	Në pronësi ose me qera
12	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri ne 3.5 ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
13	Eskavator 0.25m3 me gome	copë	1	Në pronësi ose me qera
14	Autobetoniere	copë	1	Në pronësi ose me qera
15	Elektrosaldatriçe	copë	2	Në pronësi ose me qera
16	Pompë suvatimi	copë	1	Në pronësi ose me qera
17	Gazogjen	copë	1	Në pronësi ose me qera

18	Kamionë veteshkarkues me kapacitet mbajtës 3.5 -10Ton	copë	1	Në pronësi ose me qera
----	---	------	---	------------------------

a) Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikate e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

b) Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet: a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë) c) leje qarkullimi; ç) çertifikaten e kontrollit teknik (e vlefshme) d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

c) Për mjetet e deklaruar që transportojnë mallra të klasifikuara sipas legjislacionit në fuqi të rrezikshme, duhet të paraqitet çertifikatë për transport mallrash të rrezikshëm lëshuar nga institucionet perkatese (e vlefshme).

d) Për pajisjet teknike, të cilat janë në pronësi të operatorit ekonomik, duhet të paraqitet kontrata e shitblerjes/fatura tatimore e shitjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes ndërsa kur janë të marra me qera duhet të paraqitet kontrata e qerasë, fatura tatimore e shitjes/ kontrata e shitblerjes si dhe dokumenti me të dhënat teknike të pajisjes. Në rastin kur fatura është lëshuar nga subjekte që nuk janë të regjistruar si tatimpagues të TVSH-së duhet të shoqërohet me kuponin tatimor.

e) Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të targuara duhet të jetë e dukshme ne nje foto te vetme mjeti dhe targa e tij.

- Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë me anë të së cilës pranon verifikimin e mjeteve dhe pajisjeve të deklaruar në çdo kohë deri në përfundimin e kontratës nga Autoriteti Kontraktor.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës deklaron se mjetet dhe pajisjet e deklaruar nuk janë të angazhuara në kontrata të tjera dhe nuk jane te deklaruar ne procedurat te shpallura fitues nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tirane.
- Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë për vendndodhjen e mjeteve ne pronesi ose me qera me qellim verifikimi nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mesiperme eshte vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, germa ”d” të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (e ndryshuar). Nepermjet ketyre kerkesave, Operatorët ekonomikë duhet të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që kane në dispozicion apo që mund t’u vihen në dispozicion me qellim permbushjen me sukses te kontratës objekt prokurimi.

Për të përcaktuar llojin dhe numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës, sipas zerave te preventivit dhe specifikimeve teknike te hartuara nga specialistet e fushes. Çdo mjet i kërkuar përkon me proceset ndërtimore sipas zërave përkatës të Preventivit. Numri i makinerive është përcaktuar duke marrë

në konsideratë volumet e punimeve për secilin zë pune mbështetur kjo në VKM Nr. 629 datë 15.07.2015 “Për miratimin e manualeve të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe analizat teknike të tyre”. Dokumentacioni shoqërues i kërkuar për makineritë, provon certifikimin ligjor dhe teknik të mjeteve të disponuara nëpërmjet Kontratës së Shtitjes apo Kontratës së Qirasë. Ky dokumentacion i jep garanci Autoritetit Kontraktor se punimet do të realizohen me cilësi, siguri dhe në respektim të Grafikut të Punimeve (i cili do të publikohet së bashku me Dokumentat e Tenderit).

Çdo mjet i përcaktuar sa më sipër është kërkuar në funksion të kryerjes së zerave specifike të punimeve, ndërsa numri i mjeteve është përcaktuar në varesi të volumeve të punimeve përcakton se ofertuesit dhe rrjedhimisht fituesi i mundshëm të vërtetojë se zotëron kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe Nenit 39, pika 2, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të Nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Njësia e prokurimit;

- | | |
|-------------------|---------------------|
| • Ergys Çela | Person Përgjegjës |
| • Dajana Aliaj | Specialist i fushës |
| • Sonila Kastrati | Person Përgjegjës |